

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI
TË KUFIZUAR**

Balkan carpentry Sh.p.k

- Une Mintou Fall, shtetase senegaleze, linur ne date : 30.06.1996, Senegal, me numer pashaporte: A03653059, me adrese ne : Dakar Ngore extension 12000

kam vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti.

Neni 1 - Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është **Balkan carpentry Sh.p.k**

Neni 2 - Selia

Selia e Shoqërisë është: Rr. Shyqyri Bërxolli, Rezidenca Inter - Co sat, shkalla B, Apart 27, Njesia bashkiake nr 10, Tiranë.

Neni 3 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

Neni 4 - Objekti i shoqërisë

Shoqëria ka për objekt:

- punime te pergjithshme mekanike, zdrukthtari, ndertim, instalim sistemesh hidraulike, pneumatike, hidraulike dhe elektrike, komponente dhe sisteme ne fushen detare, industriale dhe civile
- projektimi, ndërtimi , montimi i sistemeve, riparime dhe rikonstruksione
- kompania do të jetë në gjendje të marrë me qira aktive të palëvizshme ose te jap me qira makineri, pajisje ose te mira materiale.
- për të arritur qëllimin e korporatës, shoqëria do të jetë në gjendje të kryejë, brenda kufijve të ligjit, të gjitha transaksionet tregtare, industriale, si dhe të pasurive të luajtshme e te paluajtshme.

Neni 5 - Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është : 100,000 lekë.
- 5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 kuotë, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakut të vetëm në kapitalin themeltar të Shoqërisë percaktuar ne nenin 6 (gjashtë) të ketij Akti.



Neni 6 - Kontributet

6.1. Kontributi në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

- Mintou Fall, shtetase senegaleze, linur ne date : 30.06.1996, Senegal, me numer pashaporte: A03653059, me adrese ne : Dakar Ngore extension 12000, të ciles i përket nje kuotë me vlerë nominale Leke: 100,000 lekë që i korespondon 100% i kapitalit të Shoqërisë.

Neni 7 - Transferimi i kuotave

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 8 - Administrimi

8.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administratorë i Shoqërisë personi si më poshtë:

- Andrea Torracca, atësia Mauro, datëlindje 22.10.1986, qytetar Italian me numer ID shqiptare I64022004D, me vendlindje në La Spezia dhe banim në Via Giovanni Bosco 3, La Spezia, 19126, Itali, i cili emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare..

8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe nenit 14 të Statutit.

8.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t'u drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryerjen e aktivitetit të sipërpërmendur.

8.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.

Neni 9- Gjuha

9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe dhe në gjuhën italiane.



- 9.2 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin e akteve si më lartë, versioni në italisht do të jetë i vetmi version ligjërisht detyrues.

Neni 10 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 10.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 10.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ortaku i vetem

Mintou Fall



20.01.2024